




**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO**  
**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI-CORRUPTION AGENCY**

Dep.	2-D/DPK	Nr. Prot.
Dep.	03	Br. Prot.
Nr. Etik.		Prot No.
Dati/stranica		Date
Nr. paqe/s		Datum
		Date

PRISHTINE



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI – CORRUPTION AGENCY**

<b>DATË/A:</b>	24.12.2015
<b>REFERENC-Ë:</b>	AKK-DPK-03-02/4697/15
<b>PËR/ZA/TO:</b>	z. Fadil Muzaqi , Drejtor i Drejtorisë Komunale të Prokurimit në Komunën e Vushtrrisë
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Hasan Preteni, <i>[Signature]</i> Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

I nderuari z. Muzaqi,

Në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.12) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit dhe nenit 19 (paragrafi 1 pika 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me kërkesën tuaj, për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, në rastin kur Anëtari i Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë, si pronar i biznesit privat ka fituar kontratë në Komunën e Vushtrrisë. Në pajtim me mandatin që kemi dhe duke u bazuar në Ligjet bazë të Agjencisë, Agjencia kundër Korruptionit ofron këtë:



## OPINION

Ekziston konflikt i interesit në rastin e Anëtarit të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë, i cili si pronar i biznesit privat ka fituar kontratë në Komunën e Vushtrrisë, të titulluar Furnizim me artikuj ushqimorë për Autoritetin Kontraktues të Komunës së Vushtrrisë.

## ARSYETIM

Agjencia kundër Korruptionit është institucion i pavarur të cilit me Ligj i janë besuar përgjegjësi të veçanta. Sipas nenit 5 (parografi 1, nën parografi 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia është autoritet qendror i cili ndër të tjera bën edhe mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit si dhe ndërmerr masat e parapara ligjore.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit Nr.04/L-051, ka parapa kufizime, dhe ndalesa për zyrtarët e lartë, në situatë kur mund të ketë ose mund të shfaqet konflikti i interesit.

Po ashtu në bazë të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Nr.04/L-051, në nenin 4 të këtij Ligji, janë të përcaktuar kategoria e zyrtarëve të lartë publik, dhe Anëtarët e Kuvendit Komunal janë zyrtar të lartë publik dhe i nënshtrohen zbatimit të dispozitave të këtij Ligji.

Lidhur me pyetjen tuaj për situatë të konfliktit të interesit në rastin kur Anëtari i Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë si pronar i biznesit individual ka fituar kontratë në Komunën e Vushtrrisë, ju njoftojmë se rasti i tillë paraqet konflikti interesit.

Rrjedhimisht, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në nenin 15 (parografi 5), rastin e tillë e ka përcaktuar si mos pajtueshmërinë me ushtrimin e funksionit publik në të cilin shprehimisht thuhet:

*“Ndërmarrja në të cilën zyrtari i lartë ka pronësi apo pjesë të pronësisë, e drejtuar nga personi i besuar, nuk ka të drejtë të lidhi kontratë ose të përfitoj ndihmë nga institucionet qendrore ose lokale, në të cilat zyrtari i lartë është në pozitë vendimmarrëse”.*

Andaj, duke u bazuar në këtë dispozitë nënshkrimi i kësaj kontrate me zyrtarin e lartë paraqet konflikt interesit.

Ndërsa, nenin 14 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit ka përcaktuar transferimin e të drejtave në drejtimin e Ndërmarrjes, nën paragrafin 4 të këtij nenit shprehimisht thuhet:

*“Nëse personi i besuar krijon marrëdhënie afariste me institucionet e qeverisjes qendrore, lokale, ndërmarrjet publike apo me ndërmarrjet private ku kapitali i pronës publike ka më shumë*



*se pesë (5)% të kapitalit apo aksioneve, është i detyruar që të njoftoj zyrtarin e lartë lidhur me marrëdhëniet e tillë afariste”.*

Ndërsa, neni 7 i Ligjit për PKI ka përcaktuar parimet e veprimit dhe mosveprimit të zyrtarit të lartë, ndërsa në paragrafin (1, 5, 6, 8), ndër të tjera thuhet:

*“Zyrtari i lartë nuk duhet të lejoj që interesat e tij private të bien në konflikt me funksionin e tij. Ai duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, apo i mundshëm”.*

*“Zyrtari i lartë nuk ka të drejt të shfrytëzojë funksionin publik për përfitim të kundërligjshëm për vete apo për të tjeterë”.*

*“Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk ka të drejt të krijojë marrëdhënie varësie nga persona tjera që do të mund të ndikonin në paanshmërinë dhe shprehjen e vullnetit të lirë në vendimmarrje”.*

*“Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik duhet të veproj në mbrojtje të interesit publik dhe nuk ka të drejt që interesin e tij privat ta vërë para interesit publik, për mbrojtjen e të cilit është zgjedhur apo emëruar”.*

Po ashtu, neni 9 i Ligjit për PKI ka përcaktuar parimet e veprimit dhe mosveprimit të zyrtarit të lartë, në paragrafin (4,6,7,8,9), të këtij nenit ndër të tjera thuhet se zyrtarit të lartë publik u ndalohen këto veprime:

*“Të ndikojë në vendimin e ndonjë zyrtari apo organi për arsyen e përfitimit material personal apo personit në lidhje me të”.*

*“Të ndikojë në marrëdhënie të punëve apo furnizimeve publike për përfitime personale”.*

*“Të shfrytëzojë informatat e besueshme që i ka në dispozicion apo të marra në mirëbesim në ushtrimin e funksionit për përfitime personale apo për përfitime të personave të afërt apo te besueshëm”.*

*“Të ndërmarr veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten interesit personal të tij apo interesit të personave të afërt apo te besueshëm”.*

Duke u bazuar në këtë se çka u tha më lartë, kërkojmë nga ju që ti ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme, konform këtij opinion, për të parandaluar gjendjen e konfliktit të interesit sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Me respekt!

